VENDIM
Nr. 122, datë 14.10.2015

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË "ENERGY SUPPLY" SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 6, DATË 2.2.2011

Në mbështetje të neneve 16, 43, 110, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4 pika 1 germa "g" dhe 16 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Energy Supply" sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energy Supply" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germa "a", "b" dhe "c") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë "ENERGY SUPPLY" sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 6, datë 2.2.2011, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti